



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 67, datë 11.11.2025



PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 3,061,841 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit: "*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*"- kodi i produktit 91707AB dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 3,061,841 (tremilion e gjashtëdhjetë e njëmijë e tetëqind e dyzetë e një) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër	Njësia Administrative	Data e kërkesës	Shkaku i fatkeqesise sipas --VKM-së 329, datë 16.5.2012, - ligjit 45/2019 “ Për mbrojtjen civile”	Preventivi për orendit/sendet llogaritur nga KQD	Preventivi për materiale ndërtimi llogaritur nga KQD, në masën 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012	Vlera e dëmit totale përfitues
1	Sabri Murrizi	Nr.4	19.04.2024	Zjarri	694,000	-	694,000
2	Brunilda Bektashi	Nr.3	06.09.2024	Zjarri	547,000	147,834	694,834
3	Ibrahim Jaupaj	Nr.4	07.01.2025	Zjarri	513,000	21,794	534,794
4	Lavdrim Kica	Sukth	04.04.2025	Zjarri	148,549	131,831	280,380
5	Ervis Mehmeti	Nr.6	07.04.2025	Zjarri	280,454	73,475	353,929
6	Dashamir Boshnjaku	Katund i Ri	28.05.2025	Zjarri	356,666	147,238	503,904
Total							3,061,841

- Ky fond do të merret nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile, i akorduar me kodin e produktit: 91707AB, “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”.
- Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës


Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 12.11.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 798/16 prot.

Durrës, më 14 . 11 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.67 datë 11.11.2025 ,” Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 3,061,841 lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

